



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

BURSA PËR STUDIME PASUNIVERSITARE NË KORENË E JUGUT

Shkolla KDI për "Politikat dhe Menaxhimin Publik" në Korenë e Jugut, (*KDI School of Public Policy and Management*), për vitin akademik 2018-2019, ofron bursa studimi për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të kryejnë studimet pasuniversitare në programet e studimit Master në fushat e mëposhtme:

- Master për Politikën Publike (Master of Public Policy, MPP);
- Master për Politikën e Zhvillimit (Master of Development Policy, MDP);
- Master për Menaxhimin Publik (Master of Public Management, MPM);

Misioni i kësaj shkolle është të trajtojë dhe përgatisë drejtues të së ardhmes në sektorët publikë dhe privatë. Shkolla KDI për "Politikat dhe Menaxhimin Publik" mundëson një kombinim të shkëlqyer të njohurive të fituara bashkëkohore akademike dhe zbatimit të tyre në praktikë në kuadër të risive dhe prioriteteve kyçe të vendosura nga politikën kombëtare.

Programi i Bursave të Qeverisë Koreane (Korean Government Scholarship Program-NIIED GKS-KGSP) për studentët ndërkombëtarë sponsorizohet nga Instituti Kombëtar për Arsimin Ndërkombëtar (NIIED) dhe synon të promovojë shkëmbimin ndërkombëtar dhe partneritetet të ndërsjellë midis vendeve pjesëmarrëse. Ky institucion pranon çdo vit 70 studentë të ekselencës nga e gjithë bota në programet e saj.

Kandidatët pasuniversitare që dëshirojnë të ndjekin këto studime duhet të kenë kualifikimin e domosdoshëm për t'u pranuar në shkollën KDI. Ata duhet të kenë përfunduar studimet në programe bachelor ose master pranë universiteteve ose shkollave të larta në Republikën e Shqipërisë ose jashtë vendit.

Kandidatët, gjithashtu, duhet t'i nënshtrohen testimit ndërkombëtar: TOEFL, IELTS, ose TOEIC, duke qene se kurset zhvillohen në gjuhën angleze.

Shpenzimet e udhëtimit, tarifat e shkollimit si dhe bursa mujore do të mbulohen nga Instituti Kombëtar për Arsimin Ndërkombëtar (NIIED), në kuadër të Programit të Bursave të Qeverisë Koreane (Korean Government Scholarship Program-NIIED GKS-KGSP).

Për një informacion më të detajuar për kushtet e aplikimit për bursat e shkollës KDI, referojuni materialeve informative bashkëlidhur këtij njoftimi ose adresave të internetit për sa më poshtë :

Admissions Office

KDI School of Public Policy and Management

263 Namsejong-ro, Sejong, 30149,

Republic of Korea

Tel: 82-44-550-1281 or 1220 ;

E-mail: internationaladmissions@kdis.ac.kr

Website: <http://admissions.kdischool.ac.kr>

https://www.kdischool.ac.kr/#/admissions/cp/international/application_guideline

Afati i fundit për aplikim është **data 24 maj 2018**.

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS